

VENDIM
Nr.293, datë 14.4.2011

**PËR KOMPENSIMIN E VLERËS SË TAKSËS SË BIZNESIT TË VOGËL, TË
PËRDORUR PËR RIMBURSIMIN E PAJISJEVE FISKALE DHE TAKSIMETRAVE
PËR 7 KOMUNA DHE 3 BASHKI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale dhe taksimetrave, njësi të qeverisjes vendore, 7 komuna dhe 3 bashki, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ky fond, në vlerën 237 114 774 (dyqind e tridhjetë e shtatë milionë e njëqind e katërmëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë, të përballohet nga fondi i kontingjencës.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha